



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 471/5 Prot.

Tiranë, më 22/6/2017

REKOMANDIM

Nr. 21, datë 22/6/2017

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave në ngarkim të kontrolluesit "ProCredit Bank" Sh.a, Tiranë;

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit nr. 125, datë 26.04.2017, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit, "ProCredit Bank" Sh.a, me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit i Ligjit Nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë përpunimit të të dhënave personale të punonjësve.

Kontrolluesi "ProCredit Bank" Sh.a ka si objekt të veprimtarisë tregtare atë të ofrimit të shërbimeve financiare. Kontrolluesi gjatë aktivitetit të tij përpunon të dhëna personale manualisht dhe në format elektronik për kategoritë e subjekteve të të dhënave "Punëmarrës" dhe "Kandidatëve për pozicionin e lirë të punës". Të dhënat të cilat përpunohen për këto dy kategori janë emër, mbiemër, numër telefoni, e-mail, numri i sigurimit shoqëror, numri personal i identifikimit, jeta profesionale, imazhe nëpërmjet kamerave CCTV, adresa, të dhëna për shëndetin, dëshmi penaliteti, çertifikatë familjare, fotografi. Për këto kategori, kontrolluesi i përpunon të dhënat për qëllime të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe plotësimit të vendeve të lira të punës.

1. Zyra e Komisionerit gjatë hetimit administrativ të ushtruar konstatoi se, kontrolluesi nuk ka nënshkruar "Deklaratë Konfidencialiteti" me punëmarrësit të cilët kanë akses në mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale. Konfidencialiteti i parashikuar në kontratat e punës të kontrolluesit me punëmarrësit, është parë në funksion të sekretit tregtar dhe jo në kuptim të mbrojtjes së të dhënave personale të subjekteve të të dhënave (punëmarrës).

Zyra e Komisionerit vlerëson se garantimi i konfidencialitetit është mjaft i rëndësishëm pasi shpesh përhapjen dhe përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale. Nënshkrimi i "Deklaratës së Konfidencialitetit", është një detyrim i cili vë përpara përgjegjësisë për ruajtjen e konfidencialitetit, çdo punëmarrës që përpunon të dhëna personale gjatë dhe për shkak të detyrës. Në nenin 28 të Ligjit "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

parashikohet: “Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj”.

Komisioneri ka nxjerrë Vendimin nr. 6 të datës 05.08.2013 për “Përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”, si një mjet për të garantuar zbatimin e ligjit. Mospërbushja e detyrimit për të nënshkruar “Deklaratë Konfidencialiteti” përbën shkelje të nenit 28 të ligjit të sipërcituar dhe Vendimit nr.6 të Komisionerit datë 05.08.2013 për “Përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”.

2. Në kuadër të zbatimit të detyrimit për njoftim, nenet 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, u konstatua se kontrolluesi “ProCredit Bank” Sh.a, ka përbushur detyrimin për njoftim, por nuk kishte përditësuar ndryshimin e gjendjes së njoftimit lidhur me deklarinimin për kategoritë e të dhënave personale që përpunohen, kategoritë e të dhënave sensitive dhe qëllimin e përpunimit, konkretisht në rubrikat 4, 5 dhe 6 të Formularit të Njoftimit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se detyrimi për të përditësuar njoftimin nëpërmjet “Formularit të Njoftimit” është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin e të dhënave që kryen kontrolluesi dhe të ushtrojnë në mënyrë korrekte të drejtat që u jep ligji.

Në përfundim të hetimit administrativ është mbajtur procesverbali i konstatimit dhe në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në datën 06.06.2017 është mbajtur seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Kontrolluesi gjatë seancës dëgjimore ka depozituar disa dokumente dhe prova në kuadër të masave të marra në zbatim të ligjit dhe shkeljeve të konstatuara në procesverbalin e hetimit administrativ, si më poshtë:

- ✓ Është hartuar modeli i “Deklaratës së Konfidencialitetit” në përbushje të detyrimeve të nenit 28 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar dhe Vendimit nr. 6 të datës 05.08.2013 të Komisionerit për “Përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”;
- ✓ Në zbatim të detyrimit për njoftim, nenet 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, është përditësuar formulari i njoftimit në përputhje me konstatimet e grupit të inspektimit;

Sa më sipër,

Në zbatim të neneve 21, 22, 28, 29, 30, 31 pika 1/ “a/1” dhe 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi “ProCredit Bank” Sh.a, në zbatim të nenit 28 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të ketë në vëmendje përbushjen në vazhdim të detyrimit të konfidencialitetit.

2. Kontrolluesi "ProCredit Bank" Sh.a, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e formularit të njoftimit, për të gjitha ndryshimet e mundshme në përpunimin e të dhënave personale në vazhdimësinë e aktivitetit të tij.
3. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 30 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
4. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjorbë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 22 / 6 /2017

Besnik DERVISHI
Besnik Dervishi
KOMISIONERI
REPUBLIKË E SHqipërisë
KOMISIONI I MBROJTJESË DHE
KONTROLLIMIT TË DHËNAVE PERSONALE
TIRANË